

NE EMER TE POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjiilan-dega në Kamenicë, përmes gjyqtares së vetme Valbonë Dërvodeli, me sekretaren juridike Emine Zubaku, në çështjen penale kundër të akuzuarit S.GJ. nga, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 parag. 1 nënpar. 1.4 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani, PP.II.nr.215/2015 të dt.26.02.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Shtetit Ismet Ukshini, të akuzuarit S.GJ., më datën 07.09.2016 shpall publikisht, ndërsa më datën 26.09.2016 përpiloi këtë,

A K T G J Y K I M

I akuzuari S.GJ., në bazë të evidencës që disponon gjykata, i pa dënuar më parë për vepër tjetër penale, nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale,

Është fajtorë

Më datën 04.02.2015, rreth orës 11.00 min, në saktësishtë para shtëpisë së të pandehurit S.GJ. pas një fjalosje, e sulmon fizikisht bashkëfshatarin e tij S.P. duke i shkaktuar lëndime trupore. Deri te incidenti ka ardhur për shkak se S.GJ. nuk e ka lejuar firmën e autorizuar “” të instalojnë kabllon televizive në shtyllën pranë shtëpisë së tij, prandaj me të dal nga shtëpia e tij ka filluar të fyej dhe sulmuar fizikisht S. duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore , e i cili për shkak të natyrës së lëndimit detyrohet të kërkoj ndihmë mjekësore në shtëpinë e shëndetit në, gjë që vërtetohet edhe ekspertizën mjeko ligjore me numër të referencës 02/2015 e datës 18.03.2015. .

- me çka ka kryer vepër penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 parag. 1 nënpar.1.4 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,41, 46, 73, 74 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së, të akuzuarin,

E g j y k o n

Me dënim gjobe (në të holla) në shumë prej 200 (dyqind) €, të cilën shumë i akuzuari ka për ta paguar, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit apo në të kundërtën të njëjtit do t'i zëvendësohet dënimi me gjobë me dënim burgu ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

I dëmtuari S.P. për realizmin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën PP.II.nr.215/2015 të dt.26.02.2015, ka akuzuar S.GJ. nga , për shkak veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 parag. 1 nënpar.1. 4 të KPRK-së, ku edhe në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë pran aktakuzës me propozim që i akuzuari të deklarohet fajtor dhe të dënohet në përputhje me ligjin.

I akuzuari S.GJ. në mbrojtjen e tij ka kontestuar faktin se të dëmtuarin S.P. e ka kapur për fyti apo ta ketë shtrënguar në fyt duke shtuar se ditën konkrete nuk ka pasur mosmarrëveshje me të njëjtin dhe as që i ka shkaktuar lëndime trupore pasi që fare nuk e ka prekur me dorë, mirëpo nuk konteston faktin se ditën konkrete ka takuar të dëmtuarin afër shtyllës elektrike të fqinjëve, ndërsa sa i përket lëndimeve të cilat i ka paraqitur i dëmtuari të njëjtat janë të paramenduara ngase nuk ka pasur asgjë të tillë.

Në fjalën përfundimtare i akuzuari nuk e ndien vehtën fajtor se ka kryer këtë veprë penale për të cilën është ngarkuar nga prokuroria e shtetit dhe kërkon nga gjykata që t'i shqyrtoj të gjitha provat që disponon dhe ta liroj nga përgjegjësia penale,

Gjykata në procedurën provuese ka dëgjuar dëshmitarët si dhe ka bërë shikimin dhe leximin e provave materiale bashkangjitur lëndës si: raportin e mjekut me nr.675 të dt.04.02.2015, ekspertiza mjeko ligjore me numër të referencës 02/2015 të datës 18.03.2015, si dhe është shikuar foto dokumentacioni bashkangjitur lëndës .

I dëmtuari në cilësi të dëshmitarit S.P. , në dëshminë e tij ka deklaruar, se ditën konkrete derisa D.C. ka qenë në shtyllë elektrike duke instaluar kabllon e internetit, e cila kabllo ka shkuar në drejtim të shtëpisë së tij dhe fqinjëve të tij, fillimisht i akuzuari S. e ka fyer dhe ka kundërshtuar vendosjen e kabllon në shtyllën elektrike, i cili më pas e ka kapur për fyti dhe e ka shtyer, prezent kanë qenë bashkëshortja e tij M.dhe gjyshi D., për rastin ka njoftuar policinë të cilët edhe e kanë dërguar te mjeku në pasi që ka pasur dhimbje qafe, *në qafë janë vërejtur edhe gjurmët të cilat kanë qenë të theksuara në anën e majtë të qafës.*

Dëshmitari D.C. në dëshminë e tij ka deklaruar, se ditën konkrete ka qenë në, në cilësinë e montuesit të kabllon së internetit-Televizionit deri sa ka qenë lartë në shtyllë ka dëgjuar zhurmë, mirëpo pasi ka qenë i kthyer me shpinë nuk ka parë se çka ka ndodhur, ndërsa S.GJ. *tani i akuzuari ka luhatur shtyllën në të cilën ka qenë duke punuar duke i thënë që të zbres dhe ta ndërprejë punën të cilën gjë edhe e ka bërë, prezent ka qenë edhe punëtori G.M.*

Dëshmitari G.J. në dëshminë e tij ka deklaruar, se rasti ka ndodhur atëherë kur firma e autorizuar “.....” ka instaluar kabllon televizive në fshat atëherë kur kabllo është instaluar në shtyllën para shtëpisë të të akuzuarit dhe është dashur të shkohet në drejtim të shtëpisë së të dëmtuarit ka reaguar S.GJ. me arsyetimin, pse kabllo nga shtylla pranë shtëpisë së tij të shkojë në drejtim të shtëpisë së të dëmtuarit, rastin në polici e ka lajmëruar S.P. i cili ka ardhur i shqetësuar dhe sa i kujtohet *në anën e majtë të qafës ka pasur një skuqje për këtë edhe e kanë dërguar te mjeku për çka edhe ka poseduar raport mjekësor .*

Dëshmitari G.M. në dëshminë e tij ka deklaruar, se ditën konkrete së bashku me kolegun ka qenë duke bërë montimin e kabllon së internetit dhe pas montimit të kabllon ka dalur S.GJ. dhe na është drejtuar duke thënë “pse i keni vendosur këto kabllo dhe kush ju ka thënë të vini këtu“, *në rrugë i akuzuari dhe i dëmtuari kanë filluar mosmarrëveshjen lidhur me kabllot e vendosura, në vend të ngjarjes kanë qenë bashkëshortja dhe gjyshi i të dëmtuarit, personalisht ka dëgjuar mosmarrëveshjen, mirëpo nuk ka parë se të njëjtit janë rrahur mes vete pasi që ka qenë në oborrin e të akuzuarit dhe nuk ka mundur të shohë ngjarjen në tërësi.*

Dëshmitari D.P. në dëshminë e tij ka deklaruar, se ditën konkrete kanë ardhur punëtorët për të vendosur kabllon e internetit nëpër shtylla elektrike, nipi S. ka dalur për të shikuar se si po

shkon shtrirja e kabllor së internetit pas pak ka ardhur S.GJ. i cili ka *lëkundur shkallën e cila ka qenë e vendosur në shtyllë dhe gati punëtori ka ra nga shtylla*, në ato momente S. ka fyer shumë rëndë dhe për një moment *ka kapur për fyti të dëmtuarin Sashën dhe e ka shtyer*, menjëherë i njëjti ka lajmëruar rastin në polici ku më pastaj të njëjtit e kanë dërguar për t'i ofruar ndihmë mjekësore, në vend të ngjarjes ka qenë edhe bashkëshortja e të dëmtuarit S.

Gjykata vlerësoi provat një nga një dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-së, dhe erdhi në përfundim se në mënyrë të mjaftueshme nga provat që disponon gjykata është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor ashtu siç ngarkohet me akuzën e PTH-së në Gjiilan.

Nga shkresat e çështjes dhe nga provat që janë proceduar në këtë çështje penale juridike, nuk janë kontestuese faktet: se, derisa punëtorët e firmës “.....”, kanë qenë duke instaluar kabllon televizive-internetin në shtyllën pranë shtëpisë së të akuzuarit, i akuzuari ka fyer dhe ka sulmuar fizikisht të dëmtuarin S.me ç’ rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore .

Gjykata ia ka falur besimin deklaratës të të dëmtuarit në cilësi të dëshmitarit, pasi i njëjti ka përshkruar në detaje se si pas një mosmarrëveshje lidhur me vendosjen e kabllorëve të internetit i akuzuari S. e ka kapur për fyti e ka shtrënguar e më pas e ka përplasur në tokë dhe nga këto veprime të të akuzuarit, i dëmtuari ka pësuar lëndime të lehta trupore, se i dëmtuari lëndimet e lehta trupore i ka pësuar nga i akuzuari u vërtetua edhe nga dëshmitari D.P., nga ekspertiza mjeko-ligjore në të cilën është konstatuar se i dëmtuari S.P. ka pësuar *ndrydhje të indeve të buta me gjake mbledhje nën lëkurorë në regjionin e majtë të qafës* dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore dhe me pasoja të përkohshme për shëndetin,si dhe nga foto dokumentacioni bashkangjitur lëndës, gjithashtu gjykata nga dëshmitarët, D.C., G.J., G.M., vërtetoi se i akuzuari dhe i dëmtuari ditën konkrete kanë pasur mosmarrëveshje në mes tyre, pra provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësore dhe deklaratat e të dëmtuarit ishin në përputhshmëri të plotë në mes veti dhe nuk ranë ndeshë njëra me tjetër.

Gjykata ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit, i cili ka kontestuar në tërësi se ka pasur mosmarrëveshje në mes tij dhe të dëmtuarit gjithashtu mohoi të ketë sulmuar fizikisht të dëmtuarin, mirëpo mbrojtjes së tij gjykata nuk ia falë besimin pasi e konsideron të pa bazuar dhe

në kundërshtim me të gjitha provat e shtjelluara e këtë e ka bërë me qëllim që t'i shmanget përgjegjësisë penale për veprën për të cilën akuzohet .

Nga faktet që u parashtruan më parë, qartë rezulton se janë përmbushur të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 parag. 1 nënparag.1.4 të KPRK-së.

Me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit konform nenit 74 të KPPRK-së gjykata i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat të cilat në rastin konkret kanë ndikim që dënimi të jetë më i lehtë apo më i rëndë. Si rrethana lehtësuese gjykata të akuzuarit i ka marrë për bazë, bashkëpunues me gjykatën, është hera e parë që është ndeshur me ligjin, nuk zhvillohet procedure tjetër penale, mbajtës i familjes, andaj duke mos gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese të akuzuarit i ka shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata ka vlerësuar se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, ashtu që do të bëjë rehabilitimin e kryerësit e po ashtu edhe do ti parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të ngrisë forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në përgjithësi.

Për shpenzimet e procedurës penale gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 450 parag. 2 nënparag. 2.6 dhe në nenin 453 parag. 1 i KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN-DEGA NE KAMENICE-

P.64/2015, më datë 26.09.2016.

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r j a,

Emine Zubaku,d.v.

Valbonë Dërvodeli,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, për mes kësaj gjykate.